



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 5988/Prot.

Shijak, më 04.10.2022

Lënda : Kthim përgjigje kërkesës për informacion me prot.tonë nr.5988 datë 21.09.2022

Znj. Ilda Koçi
Rruga Nasi Pavllo, Pallati Edil-al, Shk.1, Kati 3, Ap.8

Në përgjigje suajës me prot.tonë nr. 5988 datë 21.09.2022, ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon, sipas rendit të çështjeve të trajtuara në kërkesën tuaj.

Së pari, në lidhje me pikën 1, ju bëjmë me dije Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.55 datë 18.08.2021 "Për miratimin e studimit të fizibilitetit, për depozitimin e mbetjeve të territorit të bashkisë Shijak në landfillin Sharrës dhe lidhjen e marrëveshjes me Z.T.M.T (landfilli i Sharrës)" e gjeni të publikuar në linkun:
<https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2021/08/VKB-Shijak-Vendimi-NR.55-Date-18.08.2021.pdf>

Së dyti, në lidhje me pikat 2, 3 dhe 4, bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion Akt-marrëveshjen "Për depozitim mbetjesh pranë Z.T.M.T" të nëshkruar ndërmjet bashkisë Shijak dhe shoqërisë koncensionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k dhe Anksin IX "Forma e angazhimit mbi detyrimet e njërive vendore të Qarkut Durrës", pjesë përbërëse e kontratës, të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.55 datë 18.08.2021 "Për miratimin e studimit të fizibilitetit, për depozitimin e mbetjeve të territorit të bashkisë Shijak në landfillin Sharrës dhe lidhjen e marrëveshjes me Z.T.M.T (landfilli i Sharrës) dhe konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës me shkresën nr. 655/1 prot. datë 23.08.2021.

Kujtojmë që Akt-marrëveshja dhe Ankesi IX janë vënë edhe më parë në dispozicion të Qendrës Faktaje, nëpërmjet znj. Aurora Shpataj me shkresën me prot. tonë nr. 5181/1 datë 07.09.2021.

Së treti, në lidhje me pikat 5 dhe 6, ju bëjmë me dije se nga momenti i mbylljes së vendepozitimit të mbetjeve në Porto-Romano me Vendim nr.1 datë 16.01.2020 të Komitetit për Menaxhimin e Intergruar të Mbetjeve për shkak të vënies në zbatim të projektit për kapsulimin e mbetjeve dhe rijetësimin e zonës në EkoPark dhe deri në datën 07 qershor 2022 mbetjet e bashkisë Shijak janë depozituar në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë

(Z.T.M.T), pa kryer anjë pagesë, siç vërtetohet edhe nga shkresa e Degës së Thesarit Durrës bashkëlidhur.

Aktualisht mbetjet depozitohen në një vend provizor të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.29 datë 09.06.2022.

Sasia e mbetjeve të depozituara në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë (Z.T.M.T) për periudhën Gusht 2021- Qershor 2022 është 3498 ton.

Së katërti, në lidhje me pikat 7, 8 dhe 9 ju bëjmë me dije se bashkia Shijak nuk ka kryer asnjë pagesë kundrejt subjektit "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k për depozitim të mbetjeve urbane pranë Zonës e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë (Z.T.M.T).

Bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion shkresën e Degës së Thesarit Durrës me nr.143/1 prot. datë 08.09.2022, që vërteton sa u përmend më sipër.

Ndaj bashkisë Shijak është lëshuar vetëm një faturë tatimore nga subjekti "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, në vlerën 5.275 €

Së pesti, në lidhje me pikat 10 dhe 11, ju bëjmë me dije se marrëveshja për depozitim të mbetjeve në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë është bazuar në :

- Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 13.01.2020 "Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta" i cili demarkoi territorin e Republikës së Shqipërisë në 10 ZMM, duke e vendosur bashkinë Shijak, si pjesë e qarkut Durrës, në ZMM-në Tiranë-Durrës.
- Vendimin e Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve nr.6, datë 20.05.2021. "Programi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, opsionet e investimeve në Shqipëri".
- Projekti në fjalë është financim i qeverisë gjermane.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.38, datë 14.06.2021 "Për miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në vendimin nr.6 datë 02.05.2021 të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimin nr.3 datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Elton Arbana

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.KRYETARI
Shpresa Dumi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK

Nr. 5025prot.
Shijak, më 23.08.2021

SHOQËRIA KONCESIONARE
“INTEGRATED ENERGY BV SPV” SH.P.K

Nr. 1362/prot
Tiranë, më 23.08.2021

AKT-MARRËVESHJE
“PËR DEPOZITIM MBETJESH PRANË
Z.T.M.T”

Kjo akt-marrëveshje lidhet me vullnet të plotë e të lirë, sot me datë 23/08/2021, midis palëve:

- “INTEGRATED ENERGY BV SPV” SH.P.K, themeluar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, me NIPT L72031013B dhe adresë: Vaqarr, Fshati Sharrë, Zona Kadastrale 3321, (Zona e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë), e përfaqësuar nga administratore Znj. Arjola Kodra.
- BASHKIA SHIJAK, Njësi Vendore e Qarkut Durrës, me adresë: Lagja “Erzen”, Shijak e përfaqësuar nga kryetari i bashkisë Z. Elton Arbana.

KUSHTE PARAPRAKE:

1. Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” Shpk me datë 31/08/2017, ka lidhur kontratën konçensionare me Nr.prot.6597 **“PËR NDËRTIMIN LANDFILLI, INCENERATORI DHE REHABILITIM I VENDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TIRANË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” (Zona e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë, më tej referuar si ZTMT)**, me Autoritetin Kontraktor Ministria e Mjedisit (kaluar kompetenca pranë Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës);
2. Kontrata e mësipërme, me të dhënat si në pikën 1 më lart, parashikon furnizimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane që do të vijnë nga Njësitë Vendore të cilat nuk janë pjesë e Qarkut Tiranë në pëputhje me Nenin 9, Pika 9.15 të saj, si dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhënë Bashkisë Shijak nëpërmjet emailit zyrtar datë 07.05.2021, i cili do të jete pjesë integrale dhe e pandarë e kësaj akt-marrëveshje depozitimi.

3. Me datë 07.12.2017 ka marrë në dorëzim nga ana e Bashkisë Tiranë Venddepozitimin ekzistues, Sharrë dhe duke filluar nga data: 31.12.2017 është plotësisht përgjegjëse për pritjen dhe menaxhimin e mbetjeve pranë **Zonës e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë (ZTMT)**;
4. **Bashkia Shijak**, njësi vendore pjesë e Qarkut Durrës gjeneron nga pastrimi i qytetit të Shijakut mbetje të tipit **urbane**, të cilat duhet t'i depozitojë në përputhje me standartet dhe brenda çdo parametri mjedisor, si dhe në përputhje me parashikimet dhe afatet e kontratës koncesionare me Nr.prot.6597 datë 31/08/2017, pranë Zonës së Trajtimit të Mbetjeve (Z.T.M.T), duke u nënshkruar menjëherë **Aneksi IX të kontratës së koncesionit "Forma e Angazhimit mbi detyrimet e njësive vendore të Qarkut Durrës"**.

PALËT BIEN DAKORT TË LIDHIN KËTË AKT-MARRËVESHJE ME KUSHTET, SI MË POSHTË VIJON:

NENI 1

QËLLIMI I AKT-MARRËVESHJES

1.1 Bashkia Shijak, do të transportojë dhe depozitojë pranë Z.T.M.T, mbetje të llojit **urbane**, në përputhje me detyrimet e parashikuara në kontratën koncesionare me Nr.prot.6597 datë 31/08/2017 dhe në përputhje me të gjitha detyrimet e kësaj akt marrëveshje depozitimi ndërmjet palëve, duke respektuar afatet si edhe sasinë e mbetjeve që vetë kjo Bashki ka deklaruar sipas Aneksit 2, pjesë integrale dhe e pandarë e kësaj akt marrëveshje.


NENI 2

DETYRIMET E BASHKISË SHIJAK

2.1 Bashkia Shijak merr përsipër detyrimin dhe çdo përgjegjësi që mund të lindë, për të qënë e pajisur vete ose nepermjet nënkontraktoreve me licence të tipit III.2.B për transport të mbetjeve në destinacionin ZTMT, Tiranë. Kjo Bashki gjithashtu merr përsipër të transportojë nepermjet mjeteve që operojnë në funksion të saj mbetjet urbane të grumbulluara nga territori **Bashkisë Shijak**.

2.2 Bashkia Shijak merr përsipër detyrimin për të nënshkruar Aneksi IX të kontratës së koncesionit **"Forma e Angazhimit mbi detyrimet e njësive vendore të Qarkut Durrës"**.

2.3 Bashkia Shijak duhet të njoftojë shoqërinë **Integrated Energy BV SPV Shpk** nëpërmjet emailit zyrtar 24 orë para:



- ALBA E SHQIPË
- a) në rast se do të ketë ndryshim të mjeteve transportuese, apo drejtuesve të këtyre mjeteve, duke deklaruar target, te dhënat e drejtuesve të tyre dhe të gjithë të dhënat e kërkuara për mjetet zëvendësuese.

2.4 Bashkia Shijak është përgjegjëse për respektimin e të gjitha procedurave dhe rregullave të shoqërisë Integrated Energy BV SPV shpk referuar mënyrës së depozitimit të mbetjeve, vendit të depozitimit apo cdo procedure e rregulloreje tjetër të komunikuar nga punonjësit e shoqërisë Integrated Energy BV SPV shpk.

2.4 Në rast se:

- a) nuk respektohen rregullat e përmedura më sipër dhe/ose
b) nga ana e koncesionarit do të konstatohet se mjetet në pronësi dhe/ose në përdorim të **Bashkisë Shijak** do të depozitojnë në vende të ndryshme jashtë territorit të ZTMT duke shkelur normat e percaktuara nga legjislacioni për mjedisin dhe duke vënë në rrezik ambientin si dhe shëndetin e qytetarëve por edhe imazhin e shoqërisë Integrated Energy BV SPV shpk,

shoqërisë Integrated Energy BV SPV shpk i lind e drejta që pas njoftimit zyrtar dërguar **Bashkisë Shijak**, të mos lejojë kalimin e mjetit përkatës të **Bashkisë Shijak**, në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë, duke mos e lejuar më këtë mjet në të ardhmen të hyjë në territorin e Z.T.M.T.

2.5 Bashkia Shijak, përcakton personin përgjegjës Znj. Enxhi Lila për të gjitha komunikimet referuar kësaj akt marrëveshjeje, marrjen në dorëzim dhe firmosjen e pranimet të faturave, si dhe shkëmbimin e cdo dokumentacioni tjetër të nevojshëm.
Te dhenat e personit përgjegjës janë:


Emër Mbiemër: Enxhi Lila

Email: retro161@live.com

Cel: 0673118492

2.6 Bashkia Shijak do të paraqesi dhe do të vendosi në dispozicion të shoqërisë Integrated Energy BV SPV shpk listen me target e mjeteve që do të kryejnë transportin e mbetjeve duke përcaktuar edhe gjeneralitetet e drejtuesve të mjeteve, të cilët do të marrin në dorëzim dhe firmosin proces-verbalet apo dokumentacionin e përgatitur nga shoqëria Integrated Energy BV SPV shpk. Kjo liste do të jetë e firmosur dhe vulosur nga **Bashkia Shijak** dhe do t'i bashkëlidhet kësaj akt marrëveshjeje si Aneks 1 i cili do të jetë pjesë integrale dhe e pandarë e saj.

2.7 Nëse gjatë kohëzgjatjes së kësaj akt-marrëveshjeje **Bashkia Shijak** e shfrytëzon këtë akt-marrëveshjeje si dhe kryen veprime të cilat bien ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi, shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" shpk, i lind e drejta që, automatikisht të konsiderojë të ndërprerë



IKAE SHQIPËRIE

këtë akt-marrëveshje dhe të mos lejojë më depozitime nga kjo Bashki. Përsa më sipër, shoqëria "Integrated Energy BV SPV" shpk, nuk mban asnjë përgjegjësi dhe nga ndërprerja e kësaj akt-marrëveshje nuk i buron asnjë detyrim kontraktual.

2.8 Bashkia Shijak, ka dijeni për sa më sipër, është dakort dhe nuk ka asnjë kundërshtim.

NENI 3 **AFATI I AKT-MARRËVESHJES**

3.1 Palët bien dakort që kjo akt-marrëveshje të lidhet për një afat *prej 5 (pesë) vite*, afat i cili do të rinovohet nëse palë do të dakortësojnë ndërmjet tyre.

NENI 4 **MËNYRA E PAGESËS**

4.1 Palët bien dakort që **Bashkia Shijak** t'i paguajë shoqërise konçesionare **Integrated Energy BV SPV shpk**, vlerën për depozitim të mbetjeve të depozituara nga territori i Bashkisë Shijak me tarifën si më poshtë:

- **29 Euro/ton pa TVSH**, kjo shumë është caktuar vetëm për depozitimin e mbetjeve të tipologjisë *urbane*.



4.2 **Bashkia Shijak shpk** do të faturohet për çdo depozitim që do të kryejë mbi baza mujore, në bazë të sasive të mbetjeve urbane që do të depozitohen. Çdo faturë do të paguhet brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit pasardhës. Në rast të tejkalimit të këtij afati, shoqëria konçesionare **Integrated Energy BV SPV shpk** gëzon të drejtën e mos lejimit të mjeteve të **Bashkisë Shijak** për depozitim të mbetjeve pranë Z.T.M.T., Sharrë.

4.3 Ky çmim vlen vetëm për depozitimin e kësaj tipologjie të mbetjeve, pra mbetje *urbane*, të klasifikuara në bazë të katalogut ligjor të klasifikimit të mbetjeve. Tarifa e depozitimit të mbetjeve

varion në varësi të tipologjisë së mbetjeve. Për çdo depozitim, krahas çdo dokumentacioni tjetër të detyrueshëm për t'u plotësuar, do të mbahet një procesverbal, ku të cilësohet pas ekzaminimit, tipologjia e mbetjeve të depozituara.

4.4 Palët janë dakort që çdo faturë e pranuar nga **Bashkia Shijak**, konform dispozitave të Kodit Civil, më saktësisht Neni 510 e vijues, përben *titull ekzekutiv*.

4.5 Duke qënë se, **Bashkia Shijak**, ka deklaruar se nuk disponon në buxhetin e saj, tarifën e depozitimit për sasi të përkatëse të mbetjeve që do t'i duhet të depozitohen pranë Z.T.M.T, kjo Bashki garanton me përgjegjësi të plotë dhe pa asnjë kufizim se përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj akt-marrëveshjeje do të sigurojë dhe do ti ofrojë shoqërisë **Integrated Energy BV SPV Sh.p.k** të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen e të gjitha pagesave për sasinë mujore të mbetjeve të depozituara pranë Z.T.M.T në kohë dhe sipas të gjitha parashikimeve të kësaj akt marrëveshjeje.





4.6 Në rast se **Bashkia Shijak** nuk kryen pagesat për sasi të mbetjeve të depozituara pranë Z.T.M.T, shoqëria Integrated Energy BV SPV Shpk, në përputhje me parashikimet e nenit 4.2 të kësaj akt marrëveshjeje si dhe në përputhje me nenin 9.3 të kontratës koncesionare Nr.prot.6597 datë 31/08/2017 ka të drejtën e ndërprejes së shërbimit duke mos lejuar depozitimin e mbetjeve nga Bashkia Shijak.

NENI 5 SPECIFIKIMI I LLOJIT TË MBETJEVE

5.1 Nëse do të kërkohet depozitim i mbetjeve të ndryshme nga ato të cituara në këtë akt-marrëveshje, paraprakisht duhet bërë një kërkesë me e-mail drejtuar shoqërisë, në mënyrë që të nënshkruhet akt-marrëveshje shtesë sipas kushteve të reja. Në rast të një kërkesë të tillë, mbetjet duhet të vijnë të diferencuara konform legjislacionit në fuqi dhe zbatimit të rregullores për depozitim të mbetjeve pranë Landfillit të Sharrës, në ZTMT.

5.2 Shoqëria koncesionare gëzon të drejtën që për çdo rast, nëse e sheh të arsyeshme, të kryejë kontroll të imtësishëm apo analiza specifike laboratorike për përcaktimin e tipologjisë së mbetjeve. Në rast se këto analiza verifikojnë përmbajtje mbetjesh me materiale, lëndë apo substanca të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë marrëveshje, **Bashkia Shijak** njoftohet, dhe koncesionari faturon me vlerën përkatëse të secilës tipologji të mbetjeve, bazuar në sasinë e depozituar.

NENI 6 SASIA E MBETJEVE QË DO TË DEPOZITOHEN

6.1 **Bashkia Shijak** ka detyrimin të përcaktojë sasi të ditore, mujore dhe vjetore të mbetjeve që pritet të gjenerojë nga pastrimi i territorit të saj, të cilat do t'i bashkëlidhen në formën Aneksit 2 bashkelidhur akt-marrëveshjes së depozitimit ndërmjet Palëve i cili do të jetë pjesë integrale dhe e pandarë e saj. Përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj akt marrëveshjeje **Bashkia Shijak** do të garantojë shoqërinë "Integrated Energy BV SPV" shpk në lidhje me furnizimin e saj me Sasi të Minimale të Mbetjeve Urbane të deklaruara në Aneksin 2 të kësaj akt-marrëveshjeje depozitimi.

6.2 Sasia e mbetjeve që do të depozitohen, mbi të cilën do të faturohet shoqëria, do të konfirmohet në çastin e mbërritjes së tyre në pranë Zonës së Trajtimit të Mbetjeve Tiranë (ZTMT), Sharrë. Kjo sasi do të peshohet në çastin e mbërritjes së mjeteve të transportit pranë ZTMT, nëpërmjet peshores së ndodhur në këtë zonë, duke peshuar fillimisht mjetet transportuese me ngarkesë dhe më tej mjetin e shkarkuar, për të llogaritur saktësisht sasinë e depozituar.

6.3 Nëse kjo procedurë nuk do të jetë e mundur për shkaqe teknike, sasia do të llogaritet manualisht, duke pasur njohuri mbi kapacitetin e mjeteve të transportit, ose me një mënyrë tjetër, sikurse palët do të bien dakort me marrëveshje.

6.4 Në momentin e depozitimit të ngarkesave të mbetjeve të transportuara dhe të sjella pranë ZTMT nga **Bashkia Shijak do të plotësohen të gjithë formularët standartë të procedurës së depozitimit** pranë shoqërisë **Integrated Energy BV SPV shpk**, për plotësimin e të cilëve do të ketë kudoherë asistencë të plotë nga punonjës të shoqërisë konçesionare **"Integrated Energy BV SPV" shpk**.

NENI 7 **DISPOZITA TË FUNDIT**

7.1 Mosmarrëveshjet, nëse do të lindin, do të zgjidhen me mirëkuptim mes paleve, e nëse kjo nuk arrihet, palët do i drejtohen organit kompetent siç përcaktohet në kontratën e konçesionit. Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë ai i përcaktuar në kontratën konçesionare Nr.prot.6597 datë 31/08/2017 .

7.2 Çdo ndryshim i kushteve të kësaj akt marrëveshje do të bëhet me shkrim, nëpërmjet një amendamenti të nënshkruar nga të dyja palët, përndryshe konsiderohet i pavlefshëm.

7.3 Akt-Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.
Kjo marrëveshje hartohet në 2 kopje me vlerë të barabartë juridike, si dhe pasi u lexua e kuptua, nënshkruhet nga palët.

PËR


BASHKINË SHIJAK

KRYETAR
ELTON ARBANA


Dr.Drejtoria Ekonomike

Pranvera Alushi



Përgj.Sektorit Juridik


Enkeleda Osmanaj


PËR

SHOQËRINË KONÇESIONARE
"INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K

ADMINISTRATORE

ARJOLA KODRA






ANEKSI IX

FORMA E ANGAZHIMIT MBI DETYRIMET E NJESIVE VENDORE TE QARKUT DURRËS

Bashkia Shijak ne perputhje me Kontraten e Koncesionit date Nr.prot.6597 datë 31/08/2017 firmosur mes Koncesionarit "Integrated Energy BV SPV" shpk dhe Ministrise se Mjedisit "PER NDERTIM LANDFILL!, INCENERATORI DHE REABILITIM I VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TIRANE DHE PRODHIMIN E ENERGIJE ELEKTRIKE" ("KONTRATA") ne menyre te parevokueshme dhe pa kushte pranojme dhe deklarojme se Bashkia Shijak eshte vene ne dijeni dhe ka pranuar , ka kuptuar te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe dalin nga Kontrata dhe anekset e saj per Bashkine dhe sa me siper:

Angazhohemi per te gjitha detyrimet qe rezultojne si te tilla, per Bashkine Shijak , duke perfshire por pa kufizuar ne kryerjen e te gjitha pagesave per depozitim dhe perpunimin e Mbetjeve, sipas cmimit 29 Euro per Ton pa TVSH dhe konform aneksit perkates, pergjate gjithe kohezgjatjes se Marreveshjes , ose cdo cmimi te modifikuar, konform dispozitave te Kontrates; dhe


Te gjitha mos-marreveshjet ne Kontrate ne lidhje me permbushjen e detyrimeve tona, do te zgjidhen ne perputhje me nenin 7 te Kontrates.

Firmosur sot më / / 2021

Bashkia Shijak

Kryetar

Elton Arbana



Dr.Drejtoria Ekonomike
Pranvera Alushi

Përgj.Sektorit Juridik
Enkeleda Osmanaj


Osmanaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PERGJITHSHME E THESARIT
DEGA E THESARIT Durrës

Nr. 5445/1. Prot
Datë 08/09/2022



Nr. 1431/1 Prot

Durrës, më 08/09 /2022

Drejtuar: Bashkia Shijak

SHIJAK

Lënda : Kthim Përgjigje Shkresës Nr. 5445/Prot , Datë 06/09/2022

Në përgjigje të kërkesës tuaj Nr. 5445 Prot. Datë. 06/09/2022 me lëndë “Kërkesë për konfirmim veprimesh me subjektin “INTEGRATED ENERGY BV SPV” shpk, ju sqarojmë se informacioni i kërkuar është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë.
<http://www.financa.gov.al/pagesa-te-krjera-nga-drejtoria-e-pergjithshme-e-thesarit-2/>

Në zbatim të udhëzimit Nr. 2 Datë 06/02/2012 *Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, Pika 6 Dhe Pika 29:*

6. Procedurat e zbatimit të fondeve buxhetore evidentohen në sistemin informatik financiar të qeverisë së administruar nga Ministria e Financave, sipas sistemit të kontrolleve të dyfishta (nënshkrimeve) për çdo transaksion financiar.

29. Raportet e monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi i parë autorizues në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, sipas afateve të përcaktuara nga Ministri i Financave.

Sa më sipër nga verifikimi në sistemin ORACLE nuk rezulton që Bashkia Shijak për periudhën 2019 – 09/2022 të ketë kryer veprime likuidimi apo pagesa në favor të subjektit “INTEGRATED ENERGY BV SPV” shpk.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Përgjegjës i Degës Thesarit

Mario SKUFI

